

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, drejtimin dhe mbikëqyrjen e administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjen në rrugë administrative të kërkesave ose ankesave që lidhen me procesin zgjedhor;

Duke vlerësuar se gjatë vitit 2025 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 dhe zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 9 nëntor 2025, në përputhje me kuadrin ligjor zgjedhor dhe me angazhimin institucional për garantimin e rregullshmërisë, transparencës dhe integritetit të procesit;

Duke mbajtur në konsideratë se zgjedhjet e vitit 2025 përfshin zhvillime të rëndësishme në administrimin zgjedhor, veçanërisht zbatimin për herë të parë në shkallë kombëtare të votimit nga jashtë vendit, përdorimin e teknologjisë zgjedhore, administrimin elektronik të raportimeve dhe monitorimin e procesit zgjedhor;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me:

Organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 maj 2025 dhe zgjedhjeve të pjesshme vendore, të datës 9 nëntor 2025, përmes miratimit të akteve nënligjore, standardizimit të dokumentacionit zgjedhor, organizimit të strukturave zgjedhore, menaxhimit logjistik dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe sigurinë e procesit.

Miratimin për zgjedhjet për Kuvend të 1173 akteve të Komisionerit Shtetëror dhe 13 vendimeve të përbashkëta me Nënkomisionerin dhe shqyrtimit të Komisionit Rregullator të 34 projektvendimeve dhe miratimit të 28 vendimeve; procesi u administrua në 93 KZAZ dhe 5 225 qendra votimi. Në funksion të procesit u shpërndanë 5274 pajisje PEI dhe 133 pajisje rezervë, u angazhuan rreth 5500 operatorë PEI, u regjistruan 53 parti politike dhe 3 koalicionet, u administruan 132 lista shumëmemërore me 2046 kandidatë, nga të cilët 140 u shpallën fitues, si dhe u akredituan 3814 vëzhgues nga 133 organizata. Për herë të parë u zbatua në shkallë kombëtare votimi nga jashtë vendit, ku aplikuan 294 155 shtetas dhe u miratuan 245 935.

Miratimin për zgjedhjet e pjesshme vendore në bashkitë Berat, Cërrik, Mat, Tepelenë dhe Vlorë, të 81 akteve nga Komisioneri, prej të cilave 3 në bashkëkompetencë me Nënkomisionerin. Procesi u zhvillua në 9 ZAZ dhe 472 qendra votimi. U shpërndanë 567 pajisje PEI dhe u akredituan 20 organizata vëzhguese dhe 358 vëzhgues jopolitikë.

Zbatimin për herë të parë në shkallë kombëtare të votimit nga jashtë vendit përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit, verifikimit të identitetit, administrimit të dërgesave postare, pranimit dhe numërimit të votave, duke krijuar një mekanizëm të ri për përfshirjen e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit në procesin zgjedhor.

Përdorimin e teknologjisë zgjedhore, përfshirë zbatimin e pajisjeve të identifikimit elektronik në qendrat e votimit, përdorimin e strukturave mbështetëse teknike, instalimin e kamerave në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave, pilotimin e votimit dhe numërimit elektronik në zona të caktuara, si dhe pilotimin e inteligjencës artificiale në numërimin e votave në zgjedhjet e pjesshme vendore në bashkinë Tepelenë.

Zhvillimin e programeve të edukimit dhe informimit të zgjedhësve, me fokus votuesit për herë të parë, zgjedhësit nga jashtë vendit, pakicat kombëtare, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara, duke përdorur media tradicionale, rrjete sociale, materiale të shtypura, platforma digjitale dhe materiale të përshtatura.

Përpjekjet për modernizimin e administrimit zgjedhor përmes përdorimit të sistemeve elektronike për rekrutim, raportim, menaxhim dokumentacioni, akreditim, gjurmim të materialeve zgjedhore dhe komunikim me zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore.

Kuvendi rekomandon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2026 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të vitit 2026.

2. Të përfshijë teknologjinë e informacionit, si fushë prioritare në Planin Strategjik 2026–2031, e cila të adresojë zhvillimin, mirëmbajtjen, sigurinë, auditimin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve digjitale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfshirë objektiva të matshëm, afate, përgjegjësi institucionale, masa për sigurinë kibernetike dhe përdorimin e teknologjive të reja në proceset zgjedhore. Strategjia t’i përcillet Kuvendit për njohje.

3. Të forcojë transparencën dhe kontrollin efektiv të financimit të fushatave zgjedhore përmes përmirësimit të sistemit elektronik të raportimit financiar, i cili duhet të përshtatet dhe bazohet në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, standardizimit të kategorive dhe përshkrimeve të shpenzimeve, verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët, si dhe publikimit të raporteve financiare në format të hapur dhe të aksesueshëm për publikun.

4. Të hartojë dhe t’i paraqesë Kuvendit një raport të veçantë për auditimin e financave të partive politike dhe të fushatave zgjedhore. Raporti të përfshijë numrin e auditimeve, subjektet e audituara, gjetjet, shkeljet e konstatuara, masat administrative të marra, statusin e publikimit të raporteve të auditimit dhe funksionimin e regjistrit të auditimit financiar.

5. Të vijojë fuqizimin e strukturës përgjegjëse për trajnimet për të siguruar forcimin e kapaciteteve të komisioneve zgjedhore të niveleve vendore dhe të Grupeve të Numërimit të Votave, duke siguruar pjesëmarrjen e anëtarëve të këtyre komisioneve në sesionet e trajnimit. Të zhvillojë më tej përmbajtjen e kurrikulave dhe standardizimin e tyre, duke përgatitur manuale të thjeshta dhe të përdorshme lehtësisht nga grupet e synuara për trajnim.

6. Të monitorojë zbatimin e masave për akses të pavarur dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor përmes verifikimit paraprak të qendrave të votimit, hartimit të një plani për përshtatjen graduale të infrastrukturës në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe forcimit të trajnimit të administratës zgjedhore për zbatimin korrekt të procedurave të votimit të asistuar.

7. Të sigurojë përmbushjen efektive të detyrimeve institucionale që lidhen me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it përmes identifikimit të masave konkrete që janë në kompetencë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe hartimit të një plani veprimi për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtyre rekomandimeve të përfshihet si seksion i përhershëm në raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

8. Të intensifikojë përpjekjet për edukimin e votuesve për votimin elektronik, identifikimin elektronik, votimin nga jashtë vendit, mënyrën e plotësimit të fletës së votimit dhe denoncimin e shkeljeve zgjedhore, me qëllim që çdo zgjedhës të ketë informacion të mjaftueshëm për të votuar në mënyrë të pavarur, të informuar dhe të sigurt.

9. Të zgjerojë objektivat dhe grupet e synuara të programeve edukuese, duke përfshirë edhe administratën publike, me module të posaçme mbi neutralitetin institucional, ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore dhe parandalimin e shkeljeve gjatë fushatës zgjedhore.

10. Të miratojë ndryshimet e nevojshme në aktet nënligjore për monitorimin e institucioneve publike dhe përdorimin e burimeve shtetërore gjatë periudhës zgjedhore, duke përcaktuar qartë kategoritë e veprimtarive të ndaluara, rastet e përjashtuara, detyrimet e raportimit dhe mekanizmat e monitorimit e të sanksionimit administrativ.

11. Të kontribuojë në analizën e përbashkët me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për krimet zgjedhore të vitit 2025, duke përfshirë problematikën e konstatuara dhe rekomandime për përmirësim.

12. Të angazhohet për përmbushjen e plotë të standardeve të transparencës institucionale, në përputhje me Programin e Transparencës dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar publikimin sistematik dhe të përditësuar të informacionit me interes publik.

13. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo katër muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre, në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

14. Të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional me AKSK-në, AMA-n dhe AKEP-in për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore, përfshirë kërcënimet kibernetike, manipulimin e informacionit, si dhe forma të tjera të ndërhyrjes hibride që mund të cenojnë integritetin e procesit zgjedhor. Të hartojë brenda muajit nëntor 2026, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, një raport për vlerësimin e rreziqeve, masat e ndërmarra, nivelin e koordinimit ndërinstitucional dhe nevojat për mbështetje.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi